

PROTOKOLL

Nga takimi i Komisionit të përbashkët për Transport ndërkombëtar rrugor ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, mbajtur në Podgoricë më 04 Maj 2017

Takimi i Komisionit të përbashkët të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi mbi Transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave është mbajtur në Podgoricë më datën 04 Maj 2014.

Lista e pjesëmarrësve është bashkëlidhur në Shtojcën 1 të këtij Protokoll.

Pas fjalës përshëndetëse të dy kryetarëve të delegacioneve, z. Xhemë Veselit, nga pala kosovare, dhe z. Dallibor Millosheviq nga pala malazeze, janë prezantuar vërejtjet hyrëse në lidhje me politikat e transportit dhe organet kompetente nga fusha e transportit në komunikacionin rrugor në të dy vende, dhe u bë prezantimi i anëtarëve të delegacionit.

Është shprehur gatishmëria reciproke e delegacioneve për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të kësaj fushe, dhe u miratua ky rend i ditës:

Pika 1 *Shkëmbimi i të dhënave statistikore për shkëmbimin e mallrave mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi*

Pika 2 *Transporti rrugor i udhëtarëve*

Pika 3 *Transporti rrugor i mallrave*

Pika 4 *Të ndryshme*

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA OŠTVA - REPUBLICA MALI MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Ngjashmësi Org. Juftimit Org. Urit	04
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	3802
Data :	08.05.17
Datum :	08.05.17
PRISHTINE/A	

Pika 1

Shkëmbimi i të dhënave statistikore për shkëmbimin e mallrave mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Të dy delegacione kanë shkëmbyer të dhënat statistikore për shkëmbimin e mallrave mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi dhe ranë dakord që përmes avancimit të raporteve të ndërsjella dhe zhvillimit të transportit të udhëtarëve dhe mallrave do të avancojnë bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve.

Pika 2

Transporti rrugor i udhëtarëve

Të dy palët ranë dakord lidhur me numrin e lejeve në bazë të të cilave kryhet transporti në linjat e rregullta të udhëtarëve mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Pala kosovare shtroi pyetje për procedurën e regjistrimit të linjave të rregullta ndërkombëtare sezonale.

Pala malazeze njoftoi se regjistrimi i orareve të udhëtimit dhe lëshimi i lejeve për ato kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar.

[Signature]

Delegacionet ranë dakord që nevojitet që organet kompetente, në tetor të vitit 2017, përmes Dhomave të tregtisë, të njoftojnë transportuesit e brendshëm për terminin e harmonizimit të linjave me qëllim që të gjithë transportuesit e interesuar, posaçërisht ata të interesuarit për linja sezonale, të njoftohen me kohë.

Pala kosovare shtroi pyetje në lidhje me periudhën e mbajtjes së linjave sezonale. Në këtë pyetje pala malazeze u përgjigj se konform rregullave kombëtare periudha e mbajtjes së linjave sezonale nuk mund të jetë më i shkurtër se tre muaj dhe përsëriti se sezoni i verës është nga 01.05 deri më 31.10, kurse sezoni i dimrit nga 01.12 deri më 31.03.

Pala malazeze ka njoftuar se harmonizimi i orareve të udhëtimit në komunikacionin rrugor ndërkombëtar kryhet gjatë muajit mars të çdo viti.

Delegacionet ranë dakord që Raportet mbi mbajtjen-mosmbajtjen e linjave mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi për vitin 2016 të shkëmbehen më së voni deri më datën 15 Qershor 2017. Për ndryshe, lejet do të revokohen për ato linja për të cilat të përcaktohet, në bazë të të dy raporteve të inspektorateve, se nuk janë mbajtur, në takimin teknik që do të mbahet në muajin shtator të vitit 2017.

Delegacionet ranë dakord që Raportet e inspektorateve kompetente për mbajtjen-mosmbajtjen e linjave të transportit të udhëtarëve mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të dërgohen në mënyrë reciproke deri më datën 15 Janar të çdo viti për vitin e kaluar.

Delegacionet ranë dakord që të mbahet një takim i departamenteve kompetente dhe organeve kompetente të kontrollit në Republikën e Kosovës, në Prishtinë, në shtator të këtij viti. Ky takim do të mbahet me qëllim të avancimit të bashkëpunimit të ndërsjellët mes organeve të kontrollit të dy vendeve dhe zgjidhjes së problemeve të evidentuara deri më tani në fushën e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.

Delegacionet ranë dakord që afati për lëshimin e lejeve për transportin e linjave të rregullta është 30 ditë pas pranimit të kërkesës. Gjithashtu, dy palët ranë dakord që transportuesi është i detyruar që ta tërhiq lejen në afat brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit për lëshimin e lejes. Në të kundërtën do të konsiderohet se ka heq dorë nga kërkesa e lëshimit të lejes.

Palët janë pajtuar që transporti i udhëtarëve vajtje-ardhje të kryhet në përputhshmëri me përkufizimin e transportit vajtje-ardhje me leje për transportin vajtje – ardhje dhe listën e udhëtarëve në dokumentin kontrollues (fletë – udhëtimi).

Në lidhje me këtë, nevojitet që dokumenti i kontrollit (fletë – udhëtimi) duhet të vërtetohet nga organi kompetent në pikën e kalimit kufitar dhe se do të tolerohet dallimi në lista deri në 10%.

Dy delegacione ranë dakord se filluar nga data 01.01.2018 transportuesit, gjatë parashtrimit të kërkesave për t'u pajisur me leje për transport vajtje – ardhje të udhëtarëve, do të jenë të detyruar të dorëzojnë këto dokumente:

- marrëveshjen mes transportuesit dhe porositesit të transportit;
- planin e udhëtimit;
- marrëveshjen/marrëveshjet mbi akomodimin e udhëtarëve që transportohen në vendin e destinacionit.

Të dy palët janë marrë vesh që të shkëmbejnë 100 leje për transportin vajtje – ardhje për vitin 2018, dhe të shkëmbejnë një numër plotësues të lejeve sipas nevojës.

Të dy palët ranë dakord të intensifikojnë punën e organeve kompetente të kontrollit dhe të shkëmbejnë raporte mbi kontrollet e kryera më së largu deri më datën 15 janar të çdo viti për vitin e kaluar.

Pika 3

Transporti rrugor i mallrave

Shefat e të dyja delegacioneve janë pajtuar se është nevoja që të nënshkruhet Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave në afatin sa më të shpejtë, duke qenë së procedurat ligjore kanë përfunduar në të dy vende.

Pala malazeze e ka informuar delegacionin e Republikës së Kosovës se përsëri duhet të shqyrtohet mundësia e kryerjes së transportit të mallrave pa leje, gjë që duhet të konstatohet në Protokollin e ri, në të cilën mënyrë do të ishin krijuar kushtet për nënshkrimin e Marrëveshjes.

Delegacioni kosovar ka shpreh qëndrimin në lidhje me politikat e transportit të Republikës së Kosovës me të cilat është parashikuar se ndaj të gjitha vendeve e ka regjimin e lejeve për/nga vendet e treta.

Pasi të dy palët kanë mbetur tek qëndrimet e veta, janë pajtuar që për këtë çështje të njoftohen Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Malit të Zi dhe pastaj qëndrimet e miratuara të shkëmbehen përmes kanaleve diplomatike.

Pika 4

Të ndryshme

Në pyetje të palës malazeze në lidhje me pagesë të siguracionit kufitar të auto-përgjegjësisë, d.th. kur mund të pritët se Republika e Kosovës të jetë pjesë e Sistemit të kartës së gjelbër, pala kosovare ka njoftuar se punohet në zgjidhje të këtij problemi dhe se do të duhej të gjendet një zgjidhje gjatë këtij viti, në të cilën mënyrë do të ishin ulur shpenzimet si të transportuesve të mallrave dhe të udhëtarëve në transportin ndërkombëtar rrugor ashtu edhe të atyre personave fizikë që kryejnë transportin me automjete të veta.

Mandej, pasi problematika në fjalë nuk është në kompetenca të ministrive të linjës, dhe me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi dhe shkurtimeve të procedurave administrative për transportuesit dhe qytetarët e ty dy vendeve, ty dy palët janë marrë vesh që të dërgojnë përsëri një nismë organeve kompetente (Ministrisë së Financave) dhe të kërkojnë ndërmarrjen e mekanizmave për zgjidhjen e problemit në interes reciprok.

Pala malazeze ka njoftuar se gjatë kontrollit të transportuesve kosovarë në lidhje me orarin e punës së shoferëve ka konstatuar një numër të madh të parregullsisë, dhe me qëllim të përmirësimit të sigurisë së komunikacionit rrugor ka njoftuar palën kosovare se do të vazhdojë me kontrolle të tilla.

Gjithashtu, pala malazeze ka njoftuar se gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2017 ka dërguar një numër të madh të transportuesve vendas për kontrolle teknike të jashtëzakonshme në raste kur gjatë kontrollit është lajmëruar dyshimi për rregullsinë e automjeteve, ashtu që kontrollet e tilla do të vazhdojnë edhe ndaj transportuesve të huaj, duke përfshirë edhe transportuesit nga Republika e Kosovës.

Takimi u zhvillua në një atmosferë konstruktive dhe miqësore dhe pala kosovare ka ftuar palën malazeze që takimi i radhës të mbahet në Kosovë.

Ky Protokoll u hartua në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhë shqipe dhe në gjuhë malazeze. Të dy versionet e Protokollit konsiderohen si origjinalë.


Për delegacionin e
Republikës së Kosovës



z. Xhemë VESELI

Për delegacionin e

Malit të Zi



z. Dallibor MILLOSHEVIQ